



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 7780 Prot.

Fier, më 17.06.2026

Lënda : Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak.

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak neni 61, si dhe Kërkesës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak, të Kryetarit të Bashkisë me Nr. 7766 Prot. Datë 17.06.2026, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Fier në sallën plenare të këshillit, ditën e **Enjte datë 25.06.2026 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **05.06.2026**.
3. Projektvendim Nr. 65 datë 17.06.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondii kushtëzuar 6 % për muajin maj 2026"
4. Informacion nga ekzekutivi për kërkesat dhe problematikat e ngritura nga këshilltarët në mbledhjen e kaluar.
5. Projektvendim Nr. 53 datë 22.05.2026 "Për dhënien e mendimit/dakortësisë në parimin mbi mënyrën e shfrytëzimit të hapsirës publike të pasurisë nr.3/399 zk. 8534 (e llojit lulishte), me sipërfaqje totale 3 702 m2 , lagja "Apollonia" Fier, në pronësi të Bashkisë Fier".
6. Projektvendim Nr 54 datë 22.05.2026 "Për miratimin në parim, mbi vijimin e mënyrës së funksionimit të tregut të fruta-perimeve (ndërtesë dy-katëshe), pasuri me nr. Inventari nr. 5/89, zk. 8534, lagja "Kastriot". Fier, në pronësi të Bashkisë fier, me qëllim vazhdimin e procedurave administrative – ligjore nga ekzekutivi I Bashkisë Fier."
7. Projektvendim Nr. 55 datë 22.05.2026 "Per miratimin e kërkesës së shoqërisë "Enterprises Albania" sh.p.k për dhënien e të drejtës për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve kontraktore

sipas kontratës nr. 1224 rep. nr. 562 kol. Dt. 18.09.2024 nga shoqëria "Enterprises Albania" sh.p.k tek shoqëria "Glow Solar" sh.p.k (SPV)

8. Projektvendim Nr. 64 datë 17.06.2026 "Për miratimin e subvencionit të qirasë për familjen e pastrehë, që kërkon të përfitojë nga subvencioni i qirasë në tregun e lirë dhe nuk ka të ardhura për të përballuar vlerën e qirasë"

9. Projektvendim Nr. 57 datë 17.06.2026 "Për miratimin e ndryshimit të pikes 2. të nenit 4, të Aktmarrveshjes nr. 14328 prot., date 17.12.2025 ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier Sh.a"

10. Projektvendim Nr. 58 datë 17.06.2026 "Për një ndryshim (rishpërndarje fondesh kapitale) në VKB nr. 118, date 11.12.2025 "Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe Buxhetit të vitit 2026."

11. Projektvendim Nr. 59 datë 17.06.2026 "Për Miratimin e Projekt Dokumentit të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Fier", Faza e I"

12. Projektvendim Nr. 60 datë 17.06.2026 "Për miratimin e projektit : "Rikostruksion I shkollës "Halit Grëmi" dhe palestër, Mbrostar Ura, Fier."

13. Projektvendim Nr 63 datë 17.06.2026 "Për përjashtimin nga pagesa e kuotës së ushqimit në çerdhe dhe kopshte për kategoritë e nënave kryefamiljare në kushte të vështira ekonomike për vitin 2026".

14. Projektvendim Nr . 61 datë 17.06.2026 "Për miratimin e shpenzimeve të varrimit për të ndjerin Dorjan Kasaj."

15. Informacion mbi Raport Monitorimi të Zbatimit të Buxhetit për 4- mujorin e I të vitit 2026".

Komisionet e Përhershme të Këshillit Bashkiak të mbledhen sipas problematikave përkatëse brenda afatit ligjor.

Kryetar Këshilli

Melsi Bogdan

